



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1326 Prot.

Tiranë, më 09.10.2024

VENDIM

Nr. 11, DATË 09.10.2024

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË UDHËHEQËSIT SHKENCORË PËR
CIKLIN E TRETË TË STUDIMIT "DOKTORATË NË MUZIKOLOGJI", NË
FAKULTETIN E MUZIKËS, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 3, në nenin 38, në pikën 4 dhe 6 të nenit 79 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 24 si dhe në nenin 106 të Statutit të Universitetit të Arteve, në Rregulloren e ciklit të III të studimeve për fitimin e gradës shkencore Doktor në Muzikologji, miratuar me VSA nr. 34, datë 17.11.2021, pasi shqyrtoi praktikën, përcjellë përmes shkresës nr. 1121/3 prot., datë 01.10.2024 të Dekanit të FM, me lëndë "Përgjigje shkresës Tuaj Nr. 1121/2, datë 10.09.2024", pasi e shqyrtoi, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Doktoranti Prof. Asoc. Hysen NIMANI, i cili ka qenë nën udhëheqjen e Prof. Isak SHEHU, të kalojë nën udhëheqjen e Prof. Asoc. Dr. Sokol SARAÇI.
2. Miratimin e Prof. Arben BASHA në listën e udhëheqësve shkencorë për ciklin e tretë të studimit "Doktoratë në Muzikologji", për vitin akademik 2024-2025, duke zëvendësuar Prof. Asoc. Dr. Edmond BUHARAJA.
3. Ky vendim t'i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për miratim përfundimtar.
4. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.




SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI




Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI



Prof. Miltiadh KUTALI



Prof. Sadik SPAHIJA



Prof. Lorenc RADOVANI


Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO



Prof. Gazmend GJOKA




Prof. Asoc. Dorian ÇENE



Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI




Prof. Asoc. Genci FUGA



Prof. Asoc. Alert CELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima



Enea TRIMI (Student FAB)



Rei KITA (Student FM)



PROF. ASOC. KRISTINA LACO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

Nr. 1121/2 Prot

Tiranë, më 07/10/2024

Lënda: Përgjigje shkresës Tuaj Nr.1121/2, datë 10.09.2024

Prof. Asoc. Dorian ÇENE
ZËVENDËSREKTOR
Universiteti i Arteve
Sheshi Nënë Tereza

Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr.1121/2, datë 10.09.2024 do të gjeni numrin e udhëheqësve për vitet akademike 2022-2023; 2023-2024 dhe 2024-2025.

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik	Grada Shkencore	Numri i udhëheqësve për vitin 2022-2023	Numri i udhëheqësve për vitin 2023-2024	Numri i udhëheqësve për vitin 2024-2025
1.	Isak Shehu	Profesor	DR	1	2	
2.	Zana Shuteriqi (Prela)	Profesor	DR	1	2	
3.	Fatmir Hysi	Profesor	DR	1	2	
4.	Ilirjana Dema	Profesor	DR	1	2	
5.	Vasil S.Tole	Profesor	DR	1	2	
6.	Kastriot Tusha	Profesor i Asociuar	DR	0	1	1
7.	Sokol Saraçi	Profesor i Asociuar	DR	0	2	0
8.	Endri Sina	Profesor		0	1	0
9.	Nestor Kraja	Profesor i Asociuar		0	1	0
10.	Bujar Sykja	Profesor		0	1	0
11.	Merita Rexha	Profesor i Asociuar		0	1	0
12.	Lorenc Radovani	Profesor		0	1	0
13.	Arian Paço	Profesor		0	0	0
14.	Arben Llozi	Profesor		0	1	0
15.	Prof. Arben Basha	Profesor		0	0	1
16.	Mirela Sykja	Profesor i Asociuar		0	1	0
17.	Holta Sina	Profesor i Asociuar	DR	0	0	1
18.	Mikaela Minga	Profesor i Asociuar	DR	0	0	1
19.	Ina Kosturi	Profesor i Asociuar		0	0	
20.	Dorian Çene	Profesor i Asociuar		0	0	1
21.	Silvana Skënderi	Profesor i Asociuar		0	0	

22.	Jusuf Beshiri	Profesor i Asociuar		0	0	1
				5	20	8

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANI

Nr. 1121/2 Prot.

Tiranë, më 09/09/2024

Lënda : Përgjigje shkresës Tuaj Nr.1121/2, datë 10.09.2024


Prof. Asoc. Dorian ÇENE
ZËVENDËSREKTOR
Universiteti i Arteve
Sheshi "Nënë Tereza"

Bazuar në shkresën Tuaj Nr. 1121/2 Prot, datë 10.09.2024 po ju përcjellim Vendimin e Komisionit të Përhershëm për dhënie të Gradës Shkencore "Doktor" në Muzikologji, për ndryshimin e udhëheqësit shkencor.

Bashkëngjitur po ju përcjellim edhe miratimin e profesorit të ri udhëheqës që zëvendëson Prof.Asoc. Dr. Edmond Buharaja.

Bashkëngjitur keni gjithë dokumentacionin përkatës.

Duke Ju falenderuar,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS

**KOMISIONI I PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS
SHKENCORE "DOKTOR" NË MUZIKOLOGJI**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2024

VENDIM

Sot më datë 26.09.2024, Komisioni i Përhershëm për Dhënie të Gradës Shkencore "Doktor" në Muzikologji u mbledh për të shqyrtuar kërkesën e doktorantit Hysen Nïmani për ndryshimin e udhëheqësit shkencor.

Pasi u shqyrtua kërkesa e doktorantit dhe po ashtu edhe kërkesa e vetë udhëheqësit shkencor, komisioni vendosi miratimin e kërkesës për ndryshim.

Pas paraqitjes së deklaratës së pranimit nga ana e Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi komisioni miratoi kalimin e doktorantit Hysen Nïmani nën udhëheqjen e tij.

**KOMISIONI I PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"
MUZIKOLOGJI**

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Asoc. Dr. Sokol SARAÇI

Prof. Asoc. Dr. Holta SINA



Drejtuar:	Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore 'Doktor' në Muzikologji
Për dijeni:	Kordinatorit të Doktoratës Dr. Edmir Ballgjati
Për dijeni:	Shefit të Departamentit K.M.D.P
Për dijeni:	Prof. Arben Llozi – Dekan i Fakultetit të Muzikës, Universiteti i Arteve Tirane
Lënda:	Kërkesë për caktimin e Udhëheqësit Shkencor

K Ë R K E S Ë

Të nderuar anëtar të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore 'Doktor' në muzikologji,

Unë Prof. Asoc. Hysen Nimani, kam aplikuar në konkursin e datës 09.10.2023, më numër protokolli 846 për tu pranuar në programin e ciklit e III -të, Doktoratë në Muzikologji me udhëheqës shkencor Prof. Dr. Isak Shehu. Bazuar në vlerësimin e shpallur nga komisioni i pranimit, jam klasifikuar fitues për temën 'Muzika korale në hapësirën mbarëshqiptare' dhe kam ndërmarre të gjitha hapat e parashikuara për regjistrimin në programin e sipërpërmendur dhe kam filluar studimin në vitin akademik 2023-2024.

Sikurse edhe jeni në dijeni, udhëheqësi i temës time, Prof. Dr. Isak Shehu, për shkak të ngarkesës dhe të pamundësisë për të ndjekur punën time kërkimore, është tërhequr nga drejtimi i doktoratës time, vendim ky që më është komunikuar nga Prof. Dr. Shehu.

Të nderuar anëtar të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore 'Doktor' në Muzikologji, nisur nga sa më sipër, tkerkoj nga ju të më caktohet si udhëheqës i doktoratës Prof.Asoc.Dr. Sokol Saraçi.

Bashkëngjitur gjeni letrën e miratimit të Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi për të udhëhequr punën time kërkimore me temën e miratuar tashmë 'Muzika korale në hapësirën mbarëshqiptare'



Më respekt

Prof. Asoc. Hysen Nimani
Universiteti "Haxhi Zeka"
Fakulteti i Arteve Pejë, Kosovë
Tel. 00383 / 44 639-278
Email: hysen.nimani@unhz.eu
Adresa: rr. "U Ç K -së" 30000 Pejë

Tiranë 24.09.2024

KËRKESË

Dreiturar: Departamentit të K M D P, pranë Fakulteti të Muzikës, U. ARTEVE, Tiranë.


Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore **DOKTOR**

Lënda: Kërkesë për ulje të ngarkesës mësimorenë Ciklin e Tretë të studimeve Doktorale, pranë këtij Departamenti.

Për arsye të daljes sime në pension, dhe pamundësisë për të ndjekur tre studentë doktorantë, kërkoj që njëri nga ato të kalojë me një udhëheqës tjetër, sipas rregullores së kësaj shkolle doktorale.

Meqë me studentet Rozana Kuka dhe Eriona Dragoicea kam nisur punën dhe jemi në process, që nga Janari i vitit të shkuar, mendoj që studenti Hysen Nimani të kalojë me Drejtues tjetër shkencor.

Me Respekt


Prof. Dr. Isak SHEHU

Tiranë më 23.09.2024



Tiranë 26/09/2024

Deklaratë e Udhëheqësit Shkencor

Unë i nënshkruari **Prof.Asoc. Dr. Sokol Saraçi** bazuar Urdhërin e Ministrisë së Arsimit Nr. 128, datë 16/03/2022 Për hapjen e programit të studimit ciklit të tretë Doktoratë në "Muzikologji", në Universitetin e Arteve Tiranë, sikurse dhe në Ligjin Nr. 80, datë 22/07/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 Për Elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, i ndryshuar, VKM Nr. 112, datë 23/02/2018 Për Përcaktimin e Kriteve për Fitimin e Gradës Shkencore "Doktor" dhe të Standarteve Shtetërore për Fitimin e Titujve Akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" i ndryshuar, Udhëzimin Nr 29, datë 10/09/2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, VKM Nr. 329, datë 12/04/2017, Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik, deklaroj se në programin e Ciklit III për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në Muzikologji për vitin akademik 2024-2025 do të ndjek, në cilësinë e Udhëheqësit Shkencor kandidatit Hysen Nimani .

Në cilësinë e udhëheqësit shkencor



Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi

Emër mbiemër firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI I KMDP

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 30.09.2024

Lënda :Njoftim për miratimin e ri të profesorit udhëheqës të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës.

Drejtuar: Prof. Asoc. Dorian ÇENE
zëvendësrektor
Universiteti i Arteve
Sheshi "Nënë Tereza"

Bazuar në shkresën e MAS me Nr. 3220/4 Prot, datë 09.09.2024 Ju bëjmë me dije se Prof. Asoc. Dr. Edmond Buharaja ishte miratuar nga Departamenti I KMDP-së në listen e udhëheqsëve të punimeve të doktoraturës për vitin akademik 2024-2025 të angazhohej në udhëheqjen shkencore të Doktoraturës në "Muzikologji" listë e cila kaloj për miratim nga Senati Akademik I UART me nr 25 dhe 29 datë 13.05.2024.

Për shkak të ndarjes së parakohshme nga jeta në date 12.09.2024,bazuar në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit të III për fitimin e gradës Shkencore "Doktor" në Muzikologji, njësinë bazë e KMDP-së në Fakultetin e Muzikës, referuar Kreut I neni 4 pika 4, miratoj udhëheqësin e ri të punimeve doktorale Prof. Arben Basha .

Bashkëngjitur do te gjeni dokumentacionin si më poshtë:

1. **Prof. Arben Basha** bashkëngjitur do të gjeni

- Kopje të deshmisë të kualifikimit për fitimin e titulli;
- Letër angazhimi
- Deklaratë
- Kontratë e punës

Me konsideratë,

Prof. Petrika Afezollu

Përgjegjësi i Njësisë Bazë KMDP





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

D I P L O M Ë

Nr. 380

Tiranë, më 26.07.2016

Nuk lëshohet dublikatë e diplomës

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TITUJVE AKADEMIKË

në mbështetje të propozimit të Senatit Akademik të

Universitetit të Arteve

dhe të Raportit përfundimtar të Komisionit të
Vlerësimit me

Vendim nr. 20

Datë 26.07.2016


I jep

Z. Arben Sami Basha

Titullin Akademik **“PROFESOR”**

Kryetar

Lindita Nikolla





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

Tiranë 27/09/2024

Letër Angazhimi

Unë i nënshkruari Prof.Arben Basha me dokumentin e identifikimi Nr 034471572 dhe numër G40831099C personal, zotërues i titullit akademik "PROFESOR" me Vendim Nr.20, datë 26.07.2016 të Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Muzikës, me numër regjistri 380.

deklaroj gatishmërinë për t'u angazhuar si Udhëheqës/Bashkëudhëheqës i kandidatëve për titullin shkencor "Doktor" pranë Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve Tiranë.

Njëherazi deklaroj se, në rastin e angazhimit si Udhëheqës/Bashkëudhëheqës, do të respektoj përcaktimet e Ligjit Nr. 80, datë 22/07/2015 *Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 *Për Elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*, i ndryshuar, VKM Nr. 112, datë 23. 02. 2018 *Për Përcaktimin e Kriterëve për Fitimin e Gradës Shkencore "Doktor" dhe të Standarteve Shtetërore për Fitimin e Titujve Akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"*, Udhëzimin Nr 29, datë 10.09.2018 *Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*, VKM Nr. 329, datë 12.04.2017, *Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik*, Statutin e Universiteti të Arteve Tiranë dhe Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III për Fitimin e Gradës Shkencore "Doktor" në Universitetin e Arteve Tiranë.

Emër mbiemër firmë

Prof. Arben Basha



DEKLARATË

Unë i nënshkruari Prof.Arben Basha jam në dijeni të VKM Nr. 112, datë 23. 02. 2018 *Për Përcaktimin e Kritereve për Fitimin e Gradës Shkencore "Doktor" dhe të Standarteve Shtetërore për Fitimin e Titujve Akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"*, i ndryshuar dhe deklaroj me përgjegjësi se aktualisht nuk jam angazhuar në asnjë Institucion të Arsimit të Lartë, në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, si drejtues shkencore në udhëheqjen e kandidatit/tëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor"

Emër mbiemër firmë

Prof. Arben Basha

